

STATUTI I PARTISË "SHPRESA DEMOKRATE"

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emri dhe sigla e Partisë

Emri i Partisë është "SHPRESA DEMOKRATE". Sigla e Partisë "Shpresa Demokrate" është: "SH D"

Neni 2

Stema e Partisë

Stema e Partisë "Shpresa Demokrate" përbëhet nga dy rathë me qendër të njëjtë. Sipërfaqja e rrethit të brendshëm vjen nga e kuqe në të zezë. Në qendër të këtij rrethi është vendosur një shqiponjë në ngjyrë gri. Sipërfaqja e rrethit anësor është ngjyrë gri, dhe brenda tij është shkruar emri i Partisë.

Neni 3

Vula e Partisë

Vula e Partisë ka forme rrethore me diametër 35 mm. Në qendër, brenda një rrethi më të vogël se ai anësor, është vendosur stema e Partisë, poshtë së cilës është shkruar viti i themelimit të Partisë: 2023. Në hapësirën mes rrethit anësor dhe atij të brendshëm është shkruar "SHPRESA DEMOKRATE".

Neni 4

Qendra e Partisë

Qendra e Partisë "Shpresa Demokrate" është në Prishtinë, "QENDRA PLANETI" Rruga Nëna Terezë pn, 10000 Prishtinë Kosovë.

Neni 5

Veprimtaria e partisë

Veprimtaria e Partisë "Shpresa Demokrate" shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 6

Burimet e financimit

Partia ka si burime financiare të e siguruara nga zhvillimi i veprimtarive financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kuotizacionet, dhe subvencionet. Anëtarësimi do të jetë pa pagesë. Të gjitha aktivitetet financiare do të jenë subject I kontrollit dhe auditimit të brendshëm financiar, veprime këto të cilat do të ushtrohen nga Komisioni financiar.

Neni 7

Lloji i votimit

Si rregull, votimi në proceset vendimmarrëse të organeve të Partisë zhvillohet i hapur. Votimi për funksione në organet drejtuese të Partisë bëhet i fshehtë, me përjashtim kur në këtë statut parashikohet ndryshe.

Neni 8

Procesi i zgjedhjeve

Në zgjedhjet për organet individuale ose për plotësimin e një vendi në organet kolegjiale të partisë, si rregull, konkurrojnë jo më pak se dy kandidatë. Përjashtim nga ky rregull përbën rasti kur, me gjithë njoftimet, deri në momentin e votimit, paraqitet vetëm një kandidaturë. Për të fituar, çdo kandidati të listës i duhet të marrë mbi 50% të votave të vlefshme. Në të kundërt, vepron parimi i balotazhit. Zgjedhjet për anëtarët e organeve kolegjiale të Partisë bëhen me listë kandidatësh.

Neni 9

Organet e partis

Shpresa Demokrate ka organet dhe komisionet e saj.

9a) Organet e Shpresës Demokrate janë:

1. Kuvendi
2. Këshilli
3. Kryesia
4. Kryetari

9b) Komisionet e Shpresës Demokrate janë:

1. Komisioni financiar
2. Komisioni statutar
3. Komisioni disiplinor

*Përbërja, organizimi, fushëveprimi, mënyra e punës dhe mënyra e marrjes së vendimeve të komisioneve rregullohet me rregullore të veçantë, e cila miratohet nga Kryesia e SHD

Neni 10

Plotësimet në organet e Partisë

Përveç kur në këtë statut parashikohet ndryshe, në rastet kur vendi i një anetari të zgjedhur ose i një funksioni individual, në një nga organet e Partisë, mbetet vakant për arsye objektive ose të largimit të të zgjedhurit nga Partia dhe koha deri në mbarimin e mandatit të këtij vendi është më e gjatë se 1/3 e mandatit përkatës, nisin procedurat zgjedhore për plotësimin e këtij vendi.

Neni 11

Mbledhja e organeve kolegjiale

Mbledhja konsiderohet e vetëthirrur kur, sipas përcaktimeve në dispozitat e këtij statuti, duhet të thirret mbledhja e radhës. Në këtë rast, drejtuesi i organit apo zëvendësi i tij, bën shpalljen e mbledhjes, duke përcaktuar kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Në raste të veçanta si dhe kur duhen marrë vendime për probleme të rëndësishme në kompetencë të organit, mund të bëhet thirrja jashtë radhës e mbledhjes së këtij organi.

Kompetencën e thirrjes së mbledhjes jashte radhës e ka 1/3 e anëtarëve, kryesia apo kryetari i atij organi si dhe organi më i lartë. Kërkesa për thirrje të mbledhjes bëhet me shkrim dhe e motivuar. Shpallja bëhet nga kryetari i forumit në fillim të mbledhjes.

Neni 12

Vlefshmëria e mbledhjes

Mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të organit që mblidhet.

Neni 13

Vendimet

Përveç rasteve të parashikuara në këtë statut, vendimi i organit është i vlefshëm, kur kanë votuar pro jo më pak se 50% + 1 e anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

Kur votat ndahen 50% me 50%, organizohet votimi i dytë, jo me herët se një jave nga i pari, me përjashtim të rastit kur Kryesia e Partisë vendos ndryshe. Në rast se edhe pas këtij votimi votat ndahen 50% me 50%, vota e drejtuesit të mbledhjes është vendimtare.

Kur janë mundësitë e parashikuara në këtë statut, pakica ka të drejtën e apelimit në organin më të lartë.

Neni 14

Dokumentacioni i mbledhjes

Eshte e detyrueshme që mbledhja e Partisë, në cdo nivel të saj të protokolohehet.

Protokolli duhet të përmbajë:

Kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.

Rendin e ditës.

Referimet kryesore.

Thelbin e diskutimeve.

Vendimet e mbledhjes.

Firmën e protokolluesit dhe të drejtuesit të mbledhjes (kryetarit të organit ose, kur është rasti, zëvendësit të tij). Protokollet arkivohen nga sektori i organizimit të degës dhe i kalojnë arkivit të Partisë.

KREU II ANËTARËT E PARTISË

Neni 15

Kushtet për të qenë anëtar

Janë anëtarë të Partisë "Shpresa Demokrate" shtetasit kosovar, që bashkohen lirisht me idealet dhe veprimin politik të saj dhe përmbushin këto kushte:

1. Kanë mbushur moshën 18 vjeç,
2. Pranojnë statutin e programin e saj,
3. Kanë figurë të pastër morale,
4. Nuk janë anëtarë të një partie tjetër.

Neni 16

Të drejtat e anëtarit të Partisë

Anëtari i Partisë ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtarinë e Partisë, të kontribuojë e të votojë në procesin e vendimmarrjes dhe të programit politik të saj, të zgjedhë e të zgjidhet në organet e parashikuara dhe në mënyrën e parashikuar në këtë statut. Anëtari i Partisë ka të drejtën të jetë kandidat i Partisë në zgjedhjet lokale e qendrore, në bazë të normave të statutit dhe të rregulloreve. Anetari i Partisë mund të japë dorëheqjen nga funksioni apo të dalë nga Partia, duke dorëzuar një njoftim me shkrim.

Neni 17

Detyrat e anëtarit të Partisë

Anëtari i Partisë i bindet statutit, rregulloreve si dhe vendimeve të organeve të Partisë të parashikuar nga statuti. Anëtari i Partisë punon për arritjen e programit të Partisë dhe zbatimin të vendimeve të saj.

Anëtari i Partisë ka këto detyra:

1. Të përmbushë detyrat, që i caktohen, në përputhje me statutin dhe programin.
2. Të respektojë normat e bashkëpunimit demokratik dhe të drejtat e pakicës.
3. Të zhvillojë frymën e transparencës, të tolerancës, të debatit konstruktiv dhe të mirëkuptimit reciprok në Parti
4. T'i përmbahet një etike civile e të kulturuar në luftën politike, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e kundërshtarit dhe të drejtën e mendimit ndryshe.
5. Të mbështesë ekonomikisht Partinë në varësi të mundësive të tij.

Neni 18

Paraqitja e kërkesës

Personi, që kërkon të anëtarësohet, paraqet kërkesën personalisht, me shkrim dhe në dy kopje, pranë seksionit përkatës të Partisë. Në kërkesë deklarohet përmbushja e kushteve të parashikuara në nenin 14.

Neni 19

Pranimi

Pranimi në Parti bëhet nga seksioni, ku anëtari i ardhshëm do të bëjë pjesë, në mbledhjen e parë të tij.

Kërkesa, që drejtohet nga një person, i cili ka bërë pjesë më parë në një parti tjetër ose ka qenë kandidat në zgjedhje apo i zgjedhur i një partie tjetër, shqyrtohet paraprakisht në kryesinë e degës së rrethit, e cila jep mendimin e saj dhe ia kthen seksionit për të marrë vendim. Mosrespektimi i kësaj procedure passjellë pavlefshmërinë e vendimit të pranimit si anëtar, të kërkuarit.

Neni 20

Ankesa për mospranim

Kerkesa për anëtarësim, e refuzuar nga seksioni përgjegjës, mund të mohet brenda 30 ditëve nga dita e refuzimit, në kryesinë e degës së Partisë

Vendimi i kryesisë së degës është i formës së prerë dhe duhet të jepet me shkrim brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së ankesës.

Neni 21

Regjistrimi

Brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit për anëtarësim, kryetari I seksionit paraqet vendimin me shkrim në seksionin e organizimit të degës së Partisë, i cili bën regjistrimin në regjistrin e anëtarëve të Partisë për degën si dhe bëhet leshimi i dëshmisë së anëtarësisë.

KREU III

ORGANIZIMI BAZË I PARTISË

Neni 22

Seksioni

Seksioni është njësia bazë e Partisë, e krijuar mbi bazën e lagjeve dhe nuk mund të ketë më pak se 5 anëtarë. Në rast se nuk plotësohet numri i parashikuar në paragrafin e mësipërm, bëhet bashkimi i anëtarëve të disa lagjeve ose fshatrave në një seksion.

Neni 23

Kryetari dhe sekretari i seksionit

Seksioni zgjedh me shumicë të thjeshtë, për një mandat kohe 5 (pesë) vjeçar, kryetarin dhe sekretarin e tij, të cilët organizojnë veprimtarinë dhe kujdesen për mbarëvajtjen e seksionit.

Neni 24

Varësia e seksionit

Nga pikepamja organizative, seksioni varet nga kryesia e degës së rrethit. Per probleme të ndryshme të verpimtarisë së tij, i drejtohet departamentit perkatës pranë kryesisë së degës.

KREU IV

ORGANIZIMI LOKAL I PARTISË

Neni 25

Dega e Partisë

Organizimi lokal i Partisë bëhet në bazë degësh, me vendim të Kryetarit ose Kryesisë së Partisë.

Anëtarët e Partisë së një qyteti dhe të fshatrave, që tradicionalisht kanë pasur si qendër atë qytet, formojnë degën e Partisë, e cila merr emrin e qytetit përkatës. Në varësi të numrit të anëtarëve dhe të afërsisë gjeografike, mund të krijohen degë edhe me anëtarët e Partisë të dy a me shumë qyteteve dhe të fshatrave rreth tyre.

Çdo degë ka vulën e vet, të miratuar nga Kryetari ose Kryesia e Partisë me vendimin e konstituimit.

Neni 26

Asambleja e degës

Asambleja e degës është organi më i lartë i degës. Asambleja e degës përbëhet nga kryetarët e seksioneve të degës, kryesia e degës dhe drejtohet nga kryetari i degës ose nga nënkryetari, kur mungon kryetari.

Asambleja e degës, si rregull, mbledhet çdo 6 muaj, por mund të mbledhet jashtë radhe për çështje të veçanta, me kërkesë të kryetarit të kryesisë së degës ose me kërkesë të 1/10 të numrit të anëtarëve të saj.

Neni 27

Kompetencat dhe detyrat e asamblesë së degës

Asambleja e degës ka këto kompetenca e detyra:

1. Shqyrton veprimtarinë e kryesisë së degës, merr vendime për çështjet e trajtuara dhe orienton ecurinë e mëtejshme të punës.

2. Përcakton kandidatët për në organet e zgjedhura të pushtetit vendor, të cilët i dërgon për miratim Kryesisë së Partisë. Kjo e fundit ia propozon Asamblesë së Partisë për miratimin përfundimtar.
3. Zgjedh kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e tjerë të zgjedhur të kryesisë së degës.
4. Përcakton projektstrukturën dhe kandidatët e administratës së kryesisë së degës dhe ia dërgon për miratim Kryesisë të Partisë.
5. Në bazë të udhëzimeve të organeve më të larta të Partisë dhe të propozimeve të seksioneve, përcakton delegatët për në Kuvendin e Partisë.

Neni 28

Kryesia e degës

Kryesia e degës është organi permanent ekzekutiv i degës, që ka për detyrë drejtimin e punëve të përditshme administrative të degës së Partisë. Kryesia e degës përbëhet nga kryetari, nënkryetari, sekretari dhe dy anëtarë.

Neni 29

Kompetencat dhe detyrat e kryesisë së degës

Kryesia e degës ka këto kompetenca dhe detyra:

1. Organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e seksioneve të degës.
2. Kordinon veprimtarinë e seksioneve me qendrën.
3. Ndjek zbatimin e statutit, të udhëzimeve dhe të detyrave nga organet më të larta.
4. Merr vendime për zbatimin e programit të Partisë dhe veprimet politike të saj për territorin, ku e shtrin veprimtarinë dega.
5. Raporton në asamblenë e degës dhe në organet e larta të Partisë.
6. U drejtohet për probleme të veçanta organeve të larta të Partisë.

Neni 30

Kryetari i degës

Kryetari është përfaqësuesi i degës. Ai organizon e drejton mbledhjet e kryesisë dhe të asamblesë së degës, firmos vendimet e këtyre organeve dhe përgjigjet për zbatimin e tyre.

Në mungesë të kryetarit të degës, detyrat e tij ushtrohen nga nënkryetari në përputhje me statutin, normat e parashikuara në rregulloret përkatëse dhe kompetencat e deleguara nga kryetari

Neni 31

Sekretari i degës

Sekretari i degës, emërohet nga Kryesia e Partisë. Ai drejton sektorët e organizimit, të personelit dhe të administratës në përputhje me statutin si dhe orientimet e udhëzimet e Kryesisë së Partisë.

Në veprimtartinë e përditshme sekretari varet nga kryetari i degës. Sekretari i degës mban përgjegjësi përpara Kryesisë së Partisë për punën e kryer.

KREU V
ORGANIZIMI QENDROR I PARTISË

Neni 32

Kuvendi i Partisë

Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë. Ai thirret jo më vonë se në çdo 5 vjet, për të analizuar vprimtarinë e Partisë dhe për të marrë vendime lidhur me veprimtarinë politike të ardhshme të saj, si dhe për çështje konkrete, të cilat i janë shtruar për shqyrtim, në bazë të parashikimeve të këtij statuti.

Kuvendi i zhvillon punimet nën drejtimin e Kryetarit të Partisë.

Për çështje të rëndësishme, me vendim të miratuar nga 2/3 e anëtarëve të këshillit të Partisë, thirret kuvendi i jashtëzakonshëm. Përfaqësimi në Kuvend behet mbi bazën e numrit të anëtarëve të partisë së degës.

Delegatet propozohen respektivisht nga seksionet dhe i dërgohen kryesisë së degës. Modalitetet e hollësishme përcaktohen nga Kryesia e Partisë.

Rregullorja e punes se Kuvendit aprovet nga Kryesia e partis me 2/3 te votave.

Anëtarët e Asamblesë së Partisë janë delegatë ekskluziv të Kuvendit.

Neni 33

Kompetencat e Kuvendit të Partisë

Kuvendi i Partisë ka këto kompetenca kryesore:

1. Me propozim të Kryesisë së Partisë, kur ka nisma edhe të 1/10-së delegatëve të Kuvendit, zgjedh Kryetarin dhe Nënkryetarin e Partisë.
2. Miraton Statutin e Partisë ose ndryshimet e tij, të propozuara nga Kryesia e Partisë ose nga 1/10 e numrit të delegatëve të Kuvendit.
3. Miraton programin e Partisë ose ndryshimet e tij, të propozuara nga Kryesia e Partisë ose nga 1/10 e numrit të delegatëve të Kuvendit.
4. Përcakton orientimin politik të Partisë.
5. Merr vendim për shpërndarjen e Partisë.
6. Ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë statut.

Vendimet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 5 të paragrafit të mësipërm, janë të vlefshme kur për to kanë votuar pro jo më pak se 2/3 e delegatëve të Kuvendit.

Neni 34

Këshilli I Partisë

1. Këshilli i partisë është organi më i lartë i saj ndërmjet dy mbledhjeve të Kuvendit.

2. Këshilli e Partisë përbëhet nga këta anëtarë me të drejtë vote:

- Kryetari e Nënkyetari i Partisë, si dhe anëtarët e Kryesisë së Partisë

- Kryetarët e degëve të Partisë,

- Deputetët dhe anëtarët e qeverisë, që janë anëtarë të Partisë

Këshilli i Partisë, si rregull, mblidhet jo më pak se dy herë në vit, por me kërkesë të Kryetarit të partisë ose me vendim të këshillit të Partisë, mund të mblidhet, për çështje të rëndësishme, edhe jashtë radhe. Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Partisë dhe vendimet e saj kanë karakter të detyrueshëm për Partinë. Vendimet e asamblesë së Partisë nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, si dhe nga personi që mban protokollin e zhvillimit të punimeve. Në mungesë të Kryetarit, nënshkrimi do të bëhet nga Nënkyetari. Në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm, nënshkrimi do të bëhet nga anëtari Kryesisë që është më i vjetër në moshë.

Neni 35

Kompetencat e Këshillit

Këshilli ka këto kompetenca:

1. Mbi bazën e propozimeve të Kryetarit të Partisë, të Kryesisë së Partisë, ose të 1/3 së anëtarëve të saj, me shumicë prej 2/3, miraton propozimet, që do t'i bëhen Kuvendit, për ndryshimet e programit, të statutit ose për shpërndarjen e Partisë.

2. Miraton platformen elektorale dhe programin e qeverisë.

3. Me propozim të Kryetarit të Partisë, ose të 1/3 së anëtarëve, zgjedh, me shumicë të thjeshtë, anëtarët e Kryesisë së Partisë.

4. Me propozim të Kryetarit të Partisë, Kryesisë të Partisë, ose të 1/3 së anëtarëve, përcakton kandidaturat për Kryetar e Nënkyetar të Partisë, të cilat do t'i paraqiten për miratim Kuvendit.

5. Me propozim të Kryetarit të Partisë, Kryesisë të Partisë, ose të 1/3 së anëtarëve, përcakton kandidatët për deputetë, për anëtarë të Këshillit të Ministrave ose për në organet e zgjedhura të pushtetit vendor.
6. Me propozim të Kryesisë së Partisë, miraton rregulloret e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit dhe të vetë Asamblesë së Partisë.
7. Miraton krijimin e organizatave të ndryshme dhe statutet e tyre, si dhe merr vendime për orientimin e tyre sipas vijës politike e ideologjike të Partisë.
8. Me propozim të Kryesisë së Partisë ose të 1/3 të anëtarëve, me shumicë prej 2/3, vendos për thirrjen jashtë rradhe të Kuvendit të Partisë dhe i propozon atij masat disiplinore për Kryetarin ose Nënkryetarin e Partisë.
9. Në rast paqartësie, me kërkesë të Kryetarit të Partisë, të Kryesisë së Partisë, apo 1/10 të anëtarëve të Asamblesë së Partisë, interpreton normat e statutit.
10. Miraton rezoluta dhe merr vendimet më të rëndësishme për veprimin politik të Partisë në periudhën mes dy kuvendeve.
11. Ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në statut ose të ngarkuara nga Kuvendi.

Neni 36

Pjesëmarrja pasive

Anëtari i këshillit ka të drejtë të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e Kryesisë së Partisë, përveç rasteve kur, për arsye të veçanta e të rëndësishme, drejtuesi i mbledhjes vendos të kundërtën.

Neni 37

Kryetari i Partisë

Kryetari i Partisë zgjidhet nga Kuvendi dhe ka mandat pesë vjeçar. prijashtim dhe perveq Tjeter Kryetari qe e ka themeluar partine ka mandate ma shume se 5 vjeqar deri te e nbaron misionin per qka eshte themelu kjo parti dhe deri te realizon ter programin e saj prat e jet Kryetar historic. Ai është përfaqësuesi i Partisë dhe anëtar ekskluziv i Kryesisë së Partisë (është i pazevensushem).

Ne rast se kryetari jep dorëheqjen ose nuk është në gjendje shëndetësore për kryerjen e detyrës, apo pa arsye nuk kryen detyrën e tij për një periudhë kohe më të gjatë se 6 muaj, me propozim të Kryesisë së Partisë mblidhet Asambleja e Partisë, e cila merr vendim për nisjen ose jo të procedurave për thirrjen e Kuvendit për zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Mandati i Kryetarit të ri do të zgjasë për aq kohë sa është koha e mbetur e mandatit të Kryetarit të mëparshëm. Procedurat për zgjedhjen e Kryetarit të ri nuk mund të nisin, nëse nga momenti i zgjedhjes do të mbeten jo më shumë se 6 muaj nga mandati i Kryetarit të mëparshëm.

Neni 38

Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Partisë

Kryetari i Partisë ka këto kompetenca dhe detyra:

1. Thërret dhe drejton mbledhjet e Kryesisë së Partisë dhe firmos vendimet e saj.
2. Drejton punimet e Asamblesë dhe të Kuvendit të Partisë.
3. Përfaqëson Partinë në bisedime të rangut të lartë.
4. Drejton politikën e brendshme dhe të jashtme të Partisë.
5. Drejton veprimtarinë e përditshme të strukturave të Kryesisë së Partisë.
6. Orienton politikisht grupin parlamentar të Partisë,
7. Paraqet në Asamble propozimet për rishikimin e Statutit dhe të Programit të Partisë
8. Zbaton vendimet e Kuvendit, të Asamblesë dhe të Kryesisë dhe relatton para tyre.
9. Emeron e shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm nga rradhët e anëtarëve të Kryesisë së Partisë.
10. Kryen detyra të tjera të parashikuara nga Statuti,
11. Kryetari mund të largoj nga partia secilin antar dhe antar në vende udhëheqese nëse kta nuk zbatojn programin dhe statusin e partis apo krijojnë përçarje apo komplot në parti.

Neni 39

Nënkryetari

Nënkryetari i Partisë zgjidhet nga Kuvendi dhe ka mandat pesë vjeçar. Ai zëvendëson Kryetarin në rastet kur ky i fundit i delegon kompetencat e tij, si dhe në rast se Kryetari është në pamundësi fizike për ushtrimin e detyrave të tij, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Nënkryetari i Partisë kryen edhe detyra të tjera të parashikuara në statut ose në rregulloret e udhëzimet e nxjerra në bazë, për zbatim të tij.

Neni 40

Sekretari i Përgjithshëm

Sekretar i Përgjithshëm emërohet, nga Kryetari i Partisë, njëri prej anëtarëve të Kryesisë së Partisë. Ai drejton nën përgjegjësinë e tij të plotë sektorët e organizimit, personelit dhe administratës. Sekretari i Përgjithshëm orienton punën e përditshme të strukturave të tjera të Kryesisë së Partisë në bazë të detyrave të parashikuara nga statuti, rregulloret dhe orientimet e Kryetarit të Partisë. Sekretari i Përgjithshëm i propozon Kryetarit të Partisë caktimin e funksionit, fushës dhe detyrave që do të mbulojë cdo anëtar i Kryesisë së Partisë. Sekretari i Përgjithshëm varet dhe mban përgjegjësi përpara Kryetarit të Partisë për përmbushjen e detyrave të tij.

Neni 41

Kryesia e Partisë

Kryesia e Partisë është organ ekzekutiv, permanent dhe më i larti i Partisë, ndërmjet dy mbledhjeve të këshillit. Ajo përbëhet nga Kryetari dhe Nënkryetari i Partisë, si dhe 7 anëtarë.

Të 7 anëtarët zgjidhen nga këshilli i Partisë dhe kanë mandat pesë vjeçar dhe duhet të jenë me arsim të lartë. Ata nuk mund të kryejnë funksione në struktura të tjera të partiake, me përjashtim të detyrave të parashikuara në këtë statut.

Kryesia e Partisë, në zbatim të kompetencave të parashikuara në Statutin e Partisë, organizohet dhe funksionon sipas strukturës, organikës dhe rregulloreve se miratuar prej saj.

Neni 42

Kompetencat e kryesisë

Kryesia e Partisë, nën drejtimin e Kryetarit të Partisë dhe në përputhje me Statutin e Programin e Partisë, si dhe me vendimet e orientimet e organeve më të larta, ka për detyrë drejtimin e përditshëm politik e organizativ të strukturave të Partisë, përfaqësimin e Partisë në marrëdhënie me të tretët dhe orientimin politik të grupit parlamentar. Kryesia e Partisë, kur nuk është detyrë e Asamblesë së Partisë, miraton strukturën, organikën dhe rregulloret e funksionimit të organeve të Partisë. Kryesia e Partisë, me kërkesë ose kryesisht, vendos përjashtimin nga Partia të personave që janë anëtarë të Partisë në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 14, ose kur janë rastet e parashikuara në nenin 42 të këtij statuti.

Kryesia e Partisë ushtron edhe kompetenca të tjera të ngarkuara sipas e në zbatim të dispozitave të statutit.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 43

Rastet e dhënies së masave disiplinore

Jepen masa disiplinore ndaj anëtarit të Partisë kur:

Dënohet penalisht për krime, që kryhen me dashje.

Shkel rëndë statutin e Partisë, duke sjellë pasoja të rënda apo veçanërisht të rënda, që çënojnë interesin e Partisë e dinjitetin e saj.

Mban qëndrime apo kryen veprime në kundërshtim me programin e Partisë, duke sjellë pasoja të rënda, të cilat çënojnë rëndë interesin e dinjitetin e Partisë.

Mban qëndrime ose kryen veprime të padenja moralisht, të cilat ulin figurën e anëtarit të Partisë dhe dinjitetin e saj.

Nuk zbaton rregulloret, udhëzimet e vendimet e marra nga organet statutore, të cilat kanë karakter detyrues edhe për atë person.

Neni 44

Llojet e masave disiplinore

Masat disiplinore janë:

1. Heqja nga funksioni.
2. Heqja nga funksioni dhe heqja për një vit e së drejtës për t'u zgjedhur në organet drejtuese të Partisë.
3. Paralajmërim për përjashtim nga Partia.
4. Përjashtim nga Partia për pikën 1 dhe 2 të nenit 42, si dhe kur anëtarësimi është bërë në kundërshtim me kriteret e parashikuara në nenin 14 të statutit.

Neni 45

Marrja e vendimit për masë disiplinore

Si rregull, vendimi për të propozuar masë disiplinore merret me shumicë prej 2/3 të votuesve të mbledhjes së forumit ku anëtari i Partisë, për të cilin propozohet masë, bën pjesë. Ky vendim nuk është i vlefshëm nëse mbledhja zhvillohet në mungesë të paqëllimshme të tij.

Masa disiplinore vendoset në organin më të lartë që funksionon në mënyrë permanente.

Masa disiplinore mund të merret edhe drejteperdrejtë nga Kryesia e Partisë, vendimi i të ciles është i vlefshëm kur kanë votuar pro 50% + 1 e anëtarëve të saj.

Kryesia e Partisë nuk mund të marrë vendim për heqjen nga funksioni ose përjashtimin nga Partia të Kryetarit apo Nënkyetarit të Partisë, si dhe për

përjashtimin nga Partia të anëtarëve të Kryesisë së Partisë.

Neni 46

E drejta për ankim

Anëtari i Partisë ka të drejtë të parashtrojë kundërshtimet e tij në organin që do të shqyrtojë propozimin, vendimi i të cilit është i paankimueshëm Organi më i lartë që merr vendime lidhur me masat disiplinore është Kryesia e Partisë vendimet e të cilës nuk mund të ankimohen.

Neni 47

Dispozita tranzitore

Përpara regjistrimit në Këshillin Qendror Zgjedhor, në mbledhjen themeluese të Partisë, grupi nismëtar zgjedh Kryetarin e Partisë. Pas regjistrimit të Partisë në KQZ, nën drejtimin e Kryetarit të Partisë, organizohet mbledhja e grupit nismëtar e cila zgjedh Nënkyetarin e Partisë dhe anëtarët e Kryesisë të Partisë. Kjo Kryesi do të ketë mandat për të drejtuar Partinë deri në Kuvendin e dytë të saj. Jo më vonë se 6 muaj pas regjistrimit të Partisë do të organizohet Kuvendi i parë i saj.

Neni 48

Shpërndarja e Partisë

Partia "Shpresa Demokrate" do të shpërndahet kur Kuvendi vendos me shumicë votash prej 3/4 e votuesve:

1. shkrirjen ose bashkimin me parti të tjera

Partia shpërndahet edhe në rastet e parashikuara me ligj. Në rast të shpërndarjes së partis, të gjitha mjetet e mbetura në parti pasi të jenë përmbushur të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve, me vendim të posaçëm të organit që merr vendim mbi shpërndarjen e partis, do të shpërndahen në organizata humanitare të vendit.

Ky status munde të korigjohet dhe të plotsohet edhe me aneks status por vetëm me pëlqimin e Kryetarit të Partisë.